



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika 10, neni 22, neni 23 paragrafi 1 dhe nenit 82 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së Punës të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) në seancën e 87 -të të KSHPK -së të mbajtur më 01.06.2023 të morri

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër. 08-5144/1 të datës 19.05.2022, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm sipas lëndës së përmendur.

Lënda me numër 08-5144/1 të datës 19.05.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-5144/1 të datës 19.05.2022 është formuarë në bazë të denoncimit anonim me pretendimet për të dhëna të paplotësuara për pronën që disponon _____ - kryetar i Këshillit të _____ .

Me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK-ja morri të dhëna për pasurin e _____, kryetar i Këshillit të _____ dhe për anëtarët e familjes së tij nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, Ministria e Punëve të Brendshme, Administrata e të Ardhurave Publike, Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas analizimit të të dhënave të marra dhe krahasimit të tyre me të dhënat nga deklarata e gjendjes pasurore dhe interesave të _____, kryetar i Këshillit të _____, KSHPK-ja konstaton se të dhënat në fletën anketuese të dorëzuar nuk përmbajnë të dhëna për tokën në Ohër që _____ është bashkëpronar me një person tjetër dhe nuk është raportuar rritje e pasurisë

së një anëtarë të familjes së tij, përkatësisht blerja e banesës në Shkup nga gruaja e tij si bashkëpronar me person tjetër.

KSHPK-ja thekson se Deklarata e paraqitur e Gjendjes Pronësore dhe e Interesave të _____ nuk është në përputhje me nenet 82 dhe 85 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, për të cilat janë përcaktuar gjopa në përputhje me nenin 109 të të njëjtit ligj. Lidhur me situatën e krijuar në këtë mënyrë, KSHPK-ja ka konstatuar përpilimin e procesverbalit për shkelje të konstatuar, pas së cilës janë lëshuar urdhërpagesa. Gjopat janë paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe janë dorëzuar ndryshime në deklaratën e gjendjes pasurore dhe të interesave me të gjitha të dhënat e detajuara.

KSHPK-ja, duke marrë parasysh të gjitha të theksuarat më parë, konstaton se situata është tejkaluar dhe nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në rastin konkret dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHITETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska**

Përgatiti: Mr. Antonija A. Tasevska - këshilltare

